



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 815/2 prot.,

Datë 19.04.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI SKUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË
TJERË

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-60016-02-22-2023 me objekt “Blerje pajisje laboratorike për Institutin e Ndërtimit” me fond limit 29,540,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

Mbetjen e skualifikuar të operatorëve ekonomikë “Isometric” SHPK, dhe “Krijon” SHPK

Ankimues: Operatori ekonomik “Medfau” SHPK
Lagjia 5, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara
Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë.

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “Isometric” SHPK
Rruga Vaso Pasha, Nr.3, B.1 Tirane

“Krijon” SHPK
Rruga e Elbasanit, nr.57, Çollak, 1044

Në datën 15.04.2023 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3026 dhe nr. 815 prot., datë 18.04.2023 e operatorit ekonomik “Medfau” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-60016-02-22-2023 me objekt “Blerje pajisje laboratorike për Institutin e Ndërtimit” me fond limit 29,540,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, konstatohet se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Medfau” SHPK, si dhe mbetjen e skualifikuar të operatorëve ekonomikë “Krijon ” SHPK,dhe “Ismomeric”SHPK për arsye të mos permbushjes së specifikimeve teknike.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”*.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Medfau” SHPK kundërshton me anë të ankesës me numër ankimi elektronik A/2023/3026 dhe nr. 815 prot., datë 18.04.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyeja e skualifikimit:

“-Operatori ekonomik nuk plotësojnë kërkesat sipas Shtojces 5 të DST “Specifikimet Teknike “ dhe pikës 4 të Seksionit 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim, pasi specifikimet e pajisjeve të ofruara në kataloget e paraqitur , nuk plotësojnë specifikimet teknike të kerkuara nga Autoriteti Kontraktor si vijon: Nr. Artikulli Mosperputhjet Medfau 1 Presa Automatikë Multifunksionale për Betonin Presioni maksimal i punës i kerkuar është mbi 700 bar, presa e ofruar e ka maximalen 315 bar. Nuk plotësohet hapësira maksimale e drites e cila duhet të jete 370mm dhe jo 415mm sa pajisja e ofruar. Numri i kanaleve (sensoreve) nuk plotësohet, pajisja e ofruar ka me pak se 6 kanale. Pajisja e ofruar nuk plotëson leximin dixhital të ngarkesës e cila ka një certifikate kalibrimi duke siguruar klasin e parë nga 2% e ngarkesës maksimale. Duhet që të sigurojë klasin e 1 nga 1% e ngarkesës maksimale. Në katalogun e perkthyer nuk jepet informacion për: Te jete e pajisur me printer. Në fushen e dorezimit është perkthyer edhe markuar kodi 1.8 UTC-0220 1.9 që deklarohet që është printer serial, i tipik termik 72 mm, gjerësi, por nuk është futur si katalog. 2 Kabinë për laboratorin e cimentos (Dollap për Mostrat e cimentos) Është paraqitur vetëm në broshurë. Në katalog nuk është

paraqitur. Dimensionet e brendshme nuk plotesohen pasi dimensioni maksimal 1450mm nuk plotesohet pasi te gjitha dimensionet jane me te vogla se ky. Lageshtira duhet te ruhet 95% deri ne ngopje dhe jo 90%. Nuk specifikohet nese behet nepermjet nje nebulizatori uji. Nuk tregohet nese mund te lidhet ose jo me nje njesi frigoriferike per kontroll me te mire te temperatures dhe me kompresor ajri. Nuk tregohet se sa rafta inoksi ka. Nuk tregohet se sa eshte temperatura e ujit ne hyrje. Nuk tregohen specifikimet e kompresorit. 3 Prese per provat ne terheqje te celikut dhe percaktimin e rezistences ne perkulje te celikut Saktesia e kerkuar eshte me rezolucion 0.01KN ose 1% te forces maksimale te ushtruar. Kjo saktesi eshte kerkuar me e mire, cka do te thote qe eshte kerkuar dhe me e vogel se 1%. Saktesia e pajisjes se ofruar leviz nga 1% deri ne 2% duke mos e plotesuar kete specifike. Nuk percaktohen specifikimet e pompes dhe grupit hidraulik qe ben te mundur funksionimin e pajisjes si dhe nuk eshte percaktuar presioni maksimal me te cilin punon pajisja. Nuk specifikohet nese pajisja ka kontroll te temperatures se vajit nga sistemi i ftohjes se ajrit. Shpetesia e testimit e kerkuar eshte rreth 190mm/min, ndersa ajo e ofruar eshte maximumi 100mm/min. Nuk percaktohet numri i kanaleve per matjen e sforcimit si dhe per sensorët e ngarkeses. Pajisja duhet te kete te pakten 6 kanale. Pajisja e ofruar nuk ka nje shpejtesi te rregullueshme kryq prej 360 mm/min ne 50 Hz Pajisja e ofertuar ka shpejtesi eshte 200mm/min. Pajisja nuk siguron kryerjen e te gjitha provave te kerkuara ne specifikime, si psh. nuk ben provat e riperkuljes si dhe nuk ben provat e terheqjese se fijeve te telit dhe rrjeten e celikut te elektro salduar, etj. Ekstensometrat e ofertuar kane gjatesi maksimale 100 mm edhe udhetim 50 mm. Ndersa ekstensomentrat e vendosura ne specifikime kane gjatesi te matesit maksimumi 20mm dhe udhetim 75mm. Pajisja ka peshe me te madhe se 3700kg. Pesha e mekanizmit te preses eshte 3700kg ndersa pesha e paketes se fuqise eshte 250kg. Ekstensometri UTM-0540 per makineri testuese universale ka mosperputhje midis fushes se dorezimit si dhe katalogut te ne faqen zyrtare te pajisjes. Gjatesia e matesit sipas fushes se dorezimit eshte 600mm ndersa ne faqen zyrtare te katalogut, ka gjatesine 10-300mm (fq ne katalog 121). Ne katalogun e ofertuar nuk jepet informacion per kodin e deklaruar UTM-5109 4 Aparat Vikat Gjilpera ballore nuk i ploteson kushtet e kerkuar. Diametri i gjilperes ballore (initial needle) duhet te jete nga 1 - 1.2mm. Gjilpera e pajisjes se ofruar eshte 1.3mm. Termometri nuk eshte i perfshire ne pajisje dhe duhet te porositet me vete. Ne specifikime eshte kerkuar bashke me pajisjen si dhe eshte kerkuar me nje diapazon te caktuar temperature e cila nuk specifikohet. 5 Vaskat e Ujit Dimensionet e brendshme sipas tabelës te bere ne fund te katalogut dhe dimensionet nga broshura e produktit ndryshojne. Dimensionet e brendshme te kerkuara jane mbi 1000x700x700mm. Pajisja e ofertuar me kodin UTC-0960 shfaqet ne specifikimet e perkthyer me dimensionet e brendshme: 700x1700x850. Ndersa tek fusha e dorezimit kodi UTC-0960 shfaqet e perkthyer me permasat e brendshme: 650x1660x1850 mm. Njeri nga dimensionet nuk e ploteson kushtin te jete mbi 700mm. Ne katalogun e perkthyer mungojne specifikimet e mposhtme: Vaskë për trajtimin e cimentos e bërë nga plastika e forte. Vaska me kapacitet mbi 550 litra. Pajisja ploteson kushtet e vellimit prej 550lt. 6 Tavoline per konsistencen e llacit Pajisja nuk ka numerues sipas broshures se paraqitur dhe sipas katalogut te faqes zyrtare ne internet. Ne katalog eshte shtuar numeruesi digital me nje tabele. Gjithashtu ne

broshure nuk shprehet nese numri i rrotullive dhe goditjeve mund te percaktohet sebashku me kohen totale te punes. Diametri i tavolines se punes duhet te jete me i madh se 300mm, pajisja e ofruar e ka 300mm. 7 Komplet Unazash Le Shatelie Ne fushen e dorezimit kontraktori ka vendosur 2 sete, dhe shton ne kete menyre 3 gure peshe nga 100gr, dhe 2 gure peshe nga 300gr, te cilet jane me teper se ciane kerkuar. Gjithashtu nuk ofrohet aparati per matjen e hapjes se unazave sic eshte kerkuar ne specifikime. 8 Peshore Analitike 200gr (0,0000) Nuk eshte i qarte modeli qe do te ofertohej. Ne katalog jane markuar dy modele te ndryshme AS 60/220.R2 edhe AS 220.R2. Te dy modelet e deklaruar nuk i plotesojne te gjitha specifikimet e kerkuara. Sipas broshures se katalogut nuk specifikohen standardet me te cilat eshte konform peshroja. Gjithashtu edhe nga broshura e shkarkuar ne internet nuk figurojne standardet EN te jene konform me peshoren. Ne perkthime tek fusha e dorezimit eshte shenuar modeli AS 220.R1 plus, por nuk gjejme dot modelin e ofertuar tek kataloget e deklaruar per te kontrolluar specifikimet. Nese futemi ne faqen eeb per modelin AS 220.R1 Plus, lineariteti i pajisjes eshte 0.2 mg , ndersa tek fusha e dorzimit eshte perkthyer devijimi tipik i lineariteti 0.06 mg. Ne tabelen e fushes se dorezimit ne katalog autori shprehet se lartesia e dhomes se peshimit eshte 250mm, ndersa dimensionet e "eighing chamber" pra te dhomes se peshimit jane 190x190x226mm, pra nuk perputhen me tabelen e bere ne katalog. Gjithashtu keto dimensione jane te tilla dhe ne broshuren e shkarkuar ne internet. Kjo gje vihet re dhe te skicat e vizatuara per dimensionet e pajisjes. 9 Furnele me 2 vatra Ne specifikimet teknike per modelin RC2 jepet: Diapazoni i temperatures: temp.ambjenti deri ne 370 oC. Ndersa ne fushen e dorezimit per modelin RC2 eshte perkthyer: Diapazoni i temperatures: temp.ambjenti deri ne 380 oC. 11 pH-meter Saktesia e temperatures nuk perputhem me specifikimet e kerkuara. Saktesia eshte +-0.2°C. Saktesia e kerkuar eshte +-0.1°C. 12 Kalcimeter (gasometer) Dimensionet e gasometrit jane me te medha se ato te specifikimeve. Pra gasometri i ofruar ka dimensione 400x200x1100mm ndersa dimensionet maksimale te pranuar jane 380x200x1000mm 13 Byreta Dixhitale Nuk paraqitet precisioni i byretes dixhitale. Emertimi i pajisjes nuk paraqitet. Eshte ne perputhje me ISO9000 dhe jo ISO 9001 14 Kroxhola Sipas katalogut, ofertuesi shprehet se kroxhola eshte konform standardeve EN1592 dhe ASTM D2042.por nga broshura e marre nga interneti vihet re qe nuk eshte konform EN dhe ASTM. Nuk eshte perkthyer Katalogu i markuar ,eshte perkthyer vetem fusha e furnizimit, edhe ne perputhje me standardet EN 12592 ,ASTM D2042. Mungon gjithashtu specifikimi i kerkuar: Kronxholat duhet te jene me volum mbi 25 ml. 16 Mikroskop Dixhital Ne katalogun original ,nuk jepen informacion per softëare (mungon katalogu i softëare). 17 Sita per percaktimin e granulometrise Sita për përcaktimin e granulometrisë Ne katalogun e perkthyer ne gjuhen shqipe nuk lexohen qarte specifikimet e perkthyer. Gjithashtu ne katalog jane shenuar me highlighter te gjitha sitat dhe jo vetem sitat e perzgjedhura te cilat jane vendosur ne fushen e dorezimit. Te perkthimi mundte lexojme qarte vetem tabelen ne fushen e dorezimit. 18 Furre e pa korrodueshme Ne perkthime nuk gjendet informacion per specifikimin: Te kete termostat sigurie per te shmangur mbinxehjen. Furra duhet te jete me kapacitet mbi 250 litra. Furra e perzgjedhur ka kapacitet 250litra. 20 Klasifikues i Mostrave me kapacitet te madh Kapaciteti mbajtes eshte 20L, nuk i permbush kushtet e specifikimeve qe duhet te jene mbi 30dm³=30L Gjithashtu nuk

percaktohet diametri i limit i materialeve te cilat mund te klasifikohen, edhe pse hapësira maksimale e hapjes është 100mm cka nenkupton qe materialet me madhesi mbi 100mm deri ne 180mm nuk mund te klasifikohen 21 Tundes i motorizuar i sitave Sipas kapacitetit pajisja mban 10 sita me diameter 300mm, por nuk specifikohet nese mban 10 sita me diameter 315mm. Gjithashtu ne specifikime teknike nuk ka nje buton per ndalim ne raste emergjente. 22 Peshore Sipas broshures dhe sipas informacionit online ne faqen e peshores, peshorja nuk është ne perputhje me EN932-5, ne specifikime nuk specifikohet kodi me te cilin peshorja operon. Ndersa ne katalog është shtuar nje tabele e cila thote se peshorja është ne perputhje me standardet EN932-5. 27 Pajisje per percaktimin e peshes specifike te agregateve te trasha Ne perkthime nuk jepet informacion per: Peshorja te kryeje peshime me varje. Tek fusha e dorezimit është shenuar qe modeli ËLC 20/A2 është e pershtatshme dhe do te instalohet siper kodit: UTË-1000. 28 Balon Le Chatelier Saktesia e kerkuar ne gradim me 0.05ml nuk plotesohet. Baloni i ofruar le Chatelier ka saktesi 0.1ml. 29 Peshore Teknike 8kg Sipas broshures dhe sipas informacionit online ne faqen e peshores, peshorja nuk është ne perputhje me EN932-5, ne specifikime nuk specifikohet kodi me te cilin peshorja operon. Ndersa ne katalog është shtuar nje tabele e cila thote se peshorja është ne perputhje me standardet EN932-5. 31 Kape Kimike Sipas tabelës se fushës se dorezimit nuk plotesohen specifikat e hapsires se punes e cila duhet te jete me e madhe se 150cm pasi dimensionet totale te kapes jane 1500/900/2000mm. Pra gjerësia është totale 1500mm dhe hapsira e punes është me e vogel se gjerësia totale. Ne perkthime nuk jepet specifikimi i meposhtem: Te kete alarm me zhurme dhe drite per nivelin e fluksit te ajrit. Dritare e levizshme me sistem parachute. 32 Vaske betoni sebashku me aksesore Kapaciteti i vaskes se ofruar nuk i ploteson 1000lt. Dimensionet e brendshme jane 800x1500x550mm ose te thena ndryshe jane 8x15x5.5 dcm. Nga prodhimi i tyre marrim 660dcm³. 1dcm³=1000lt, cka do te thote qe kapaciteti i vaskes është 660lt, pra me i vogel se i kerkuari ne specifikime.”

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret të cilat operatori ekonomik ankimues “Medfau” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “Krijon” SHPK dhe “Isometric” SHPK pjesmarrës në procedurë.

Konkretisht ngrihen pretendime se operatorët “Krijon” SHPK dhe “Isometric” SHPK nuk përmbushin specifikimet teknike si më poshtë:

Ne jemi te shqetesuar se operatorët e tjere pjesmarres nuk kane te perfshire ne ofertat e tyre:

Për të kryer testimin e kompresimit, tërheqjen indirekte, modulet shpejtësi testimi të kontrolluar nga një sistem PID.

Shfaqja e njëkohshme e ngarkesës, stresit, raporti i ngarkesës aktuale, grafiku ngarkesë-kohë, grafiku stres-lodhje, zhvendosja dhe shtrirja në %, grafiku i stresizgjatjes në %.

Ruajtja në EN ose ASTM në rezultatet e testit të ngjeshjes së betonit.

Të kryhen automatikisht testet për modulën e elasticitetit në përputhje me standardet kryesore ndërkombëtare me llogaritjen automatike të rezultateve të testit.

Arsyeja pse po mendojmë është sepse në ofertën tonë është dhënë nje pretendim për këte pjesë, ndaj jemi të sigurt që konkurrentit të synuar i mungon në ofertën e tij .

E njëjta gjë është për pajisjen 3, për testin e përkuljes dhe pajisje të tjera të shtrenjta shtesë të kërkuara.

Kemi dyshime qe operatoret e tjere nuk i kane ofruar keto.”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 19.04.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri